

ANALIZË E SHKURTËR POLITIKE, KOSOVË



Konrad
Adenauer
Stiftung



Prishtina Council on
Foreign Relations

“Marrëveshja e parë” e Brukselit - Një vit më vonë -

Prill 2014

www.kas.de/kosovo

Engjellushe Morina
Këshilli i Prishtinës për
Marrëdhënie me Jashtë

Hyrje

'Marrëveshja e Parë e Brukselit e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve', siç është emërtuar në dokumentet zyrtare të Bashkimit Evropian dhe e trumbetuar si marrëveshje historike, nuk qëndron si e vetme dhe nuk duhet të analizohet si e ndarë. Para takimeve të shumta mes dy kryeministrave (i Kosovës dhe i Serbisë) në Bruksel të cilat quan në nënshkrimin e marrëveshjes, ka pasur edhe procese të tjera të pandërprera të dialogimit, të cilat thjeshtë nuk i kanë prodhuar rezultatet e dëshiruara. Dialogu teknik, prapa të cilit është fshehur me mjeshhtëri çështja e veriut, filloi me nguti në mars të vitit 2011 si masë përcjellëse e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së së 9 shtatorit 2010, dhe i cili u udhëhoq prej zëvendëskryeminstres Edita Tahiri që e përfaqësonte palën kosovare, dhe Borko Stefanoviqit që e përfaqësonte palën serbe. Edhe pse janë arritur disa marrëveshje në sektorë të ndryshëm si për regjistrin kadastral, vulat doganore, lirinë e lëvizjes, diplomat universitare, regjistrin civil, përfaqësimin rajonal, dhe të menaxhimit të integruar të kufijve, prapë se prapë çështjet që lidhen me territorin e kontestuar në veri nuk janë diskutuar në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Të dy proceset e dialogut, ai teknik dhe ai i nivelit të lartë, u lehtësuan nga Bashkimi Evropian përmes Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë (CFSP). Baronesha Catherine Ashton, shefe e CFSP, u bë sponsorja dhe udhëheqësjë kryesore e dialogut. Takimet u mbajtën në Bruksel dhe u përkrahën fuqishëm prej Shteteve të Bashkuara. Parimet dhe parametrat në bazë të së cilëve u ndërtua procesi përmbanin elemente që kishin të bënin me 'përafrimin e palëve me BE-në; pa e paragjykuar statusin e asnjërës palë; menaxhimin e përbashkët të shtypit; për asgjë nuk pajtohemi derisa të arrihet pajtimi i përgjithshëm; BE-ja e menaxhon procesin dhe e përcakton agjendën'. Pas gati dy vjet të takimeve kokë më kokë mes Kosovës dhe Serbisë rezultoi një dokument dyfaqësh me një gjuhë të dykuptimtë dhe me pesëmbëdhjetë pika të përcaktuara jo fort qartë.¹ Një vështrim i shpejtë i këtij dokumenti i jep lexuesit përshtypjen se territori i kontestuar në veri të Kosovës është objekti kryesor i marrëveshjes së arritur mes Kosovës dhe Serbisë, dhe se tri elementet kryesore në dokument kanë të bëjnë me strukturat shtetërore: policinë; gjyqësinë dhe asociacionin e veçantë të komunave të banuara me shumicë serbe të veriut. Me fjalë të tjera, marrëveshja disa pikëshe jo vetëm që nuk është kushtetuese, por edhe sugjeron hapjen e çështjeve

që janë shtyllat kryesore të shtetit, ku duket e qartë se përbën një udhërrëfyes të një zone vetëqeverisëse autonome.

Një shënim për lexuesin: gjatë fazës së para-dialogut dhe pas dhënies së mendimit për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë², palët e përfshira filluan ta bindin publikun e gjerë se dialogu i ardhshëm kishte të bënte me normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, dhe jo për çështjet e brendshme të Kosovës, siç është territori i kontestuar në veri.

Megjithatë, Marrëveshja e Parë u pasua me një plan të zbatimit që doli në maj të vitit 2013, dhe përbëhej prej gjashtë elementeve kryesore: përshtatja e kornizës ligjore; asociacioni/bashkësia zgjedhore komunale, gjyqësia dhe dispozitat e përgjithshme.

Synimi i kësaj analize të shkurtër politike është vlerësimi i marrëveshjes një vit pas nënshkrimit të saj; nuk do të fokusohet në përshtatjen e kornizës ligjore, megjithatë kjo çështje do të trajtohet sipas paraqitjes së nevojës. Analiza e shkurtër politike do të do të përpiqet që t'i analizojë në hollësi tri pyetje të cilat e kanë përcjell procesin prej fillimit:

- A është e drejtë qasja e bashkësisë ndërkombëtare karshi çështjeve të veriut të Kosovës?
- Sa ka ecur përpara zbatimi i 'Marrëveshjes së Parë'?
- Cila është e ardhmja e 'Marrëveshjes së Parë'?

VERIU: ÇËSHTJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT APO ETNIKE E TERRITORIALE

Bashkësia ndërkombëtare deri më sot nuk ka arritur që ta trajtojë me sukses problemin e veriut të Kosovës, por i ka shkuar gjurmëve të traditës duke u marrë me këtë problem nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së pakicave.³ Por veriu i kontestuar i Kosovës nuk ka qenë dhe nuk është çështje e të drejtave të njeriut, porse është një konflikt etnik e territorial, dhe si i tillë shihet edhe nga shqiptarët edhe serbët e Kosovës, e madje edhe nga serbët e Serbisë. Kjo nuk sugjeron se qasja e të drejtave të njeriut nuk duhet të kihet parasys, por

²Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, *Përputhja me të drejtën ndërkombëtare e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Mendimi këshillëdhënës i 22 korrikut 2010.*

³Andreas Ernst, 'Zgjedhjet lokale në Kosovë – një hap më afër normalizimit?' *Reflektim kritik*. 19 dhjetor 2013.

¹Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. 19 prill 2013.

duhet të kombinohet me qasjen etnike dhe territoriale me qëllim që të lëvizet më afër integritetit sesa çintegritit të bashkësive. Në realitet, banorët e veriut të Kosovës të cilët janë kryesisht serbë do ta kenë policinë dhe sistemin e vet gjyqësor, si dhe asociacionin e tyre të komunave, kurse pjesa tjetër e Kosovës, duke përfshirë edhe pakicat e tjera, do të qeverisen prej institucioneve ekzistuese. Jo vetëm që kjo i ndan bashkësitë, por edhe i përcakton 'kufijtë' të territoreve të ndryshme etnike në Kosovë.

Natyrshëm që marrëveshja nuk është një punë e kryer meqë zbatim i saj jo vetëm që ka ngecur, por dhe se shenjat e suksesit ende janë të mjegulluara. Megjithatë, nëse do ta konsideronim në mënyrë hipotetike se marrëveshja është zbatuar, atëherë pamja e shtetit të Kosovës në vitet në vijim do të jetë ajo e një shteti dy etnikë sesa e një shteti shumetnik siç është paraparë fillimisht nga bashkësia ndërkombëtare, duke filluar prej Konferencës së Rambujesë e deri te plani i Ahtisarit e te Kushtetuta e Kosovës.⁴

Një shënim tjetër për lexuesin: Plan i Ahtisarit ishte rezultat i negociatave mbi dyvjeçare mes Kosovës dhe Serbisë (2005-2007) sa i përket statusit përfundimtar të Kosovës, që qoi në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008 në bashkërendim të ngushtë me palët e ndryshme të bashkësisë ndërkombëtare.

Ishte mu pas shpalljes së pavarësisë kur ndryshoi në mënyrë dramatike realiteti në terren në veri të Kosovës, pikat kufitare u dogjën, gjykata rajonale e vendosur në veri të Mitrovicës u sulmua dhe u shkatërrua ndërsa të gjithë punonjësit e saj u detyruan të largoheshin. Zyrtarët policorë serbë që shërbenin në Policinë e Kosovës dhanë dorëheqje dhe veriu i vendit u shndërrua në një zonë të paligjshme. E gjithë kjo ndodhi nën hundën e bashkësisë ndërkombëtare, të UNMIK-ut dhe të trupave të KFOR-it.

Veriu me të drejtë përbën çelësin e një zgjidhje afatgjate të stabilitetit të vendit që rri si mjegulla mbi krye karshi zhvillimit të një shteti me funksionalitet të plotë të Kosovës. Që pas luftës së vitit 1999 kur ndryshoi demografia në këtë zonë, ku shqiptarët e Kosovës u zhvendosën në pjesën jugore, ndërsa serbët e Kosovës që vinin nga zona të ndryshme të Kosovës u përqendruan në veri, ky territor është shndërruar në një zonë të kontestuar

dhe në një konflikt të ngrirë. Brenda pak vitesh e tërë kjo zonë e krijoi llojin e vet të sovranitetit, të vetëqeverisjes dhe të vetëkontrollit, i mbështetur nga aspekti politik dhe financiar prej shtetit të Serbisë, dhe pothuaj asnjëherë të ndikuar nga autoritetet e Prishtinës. Mungesa e një plani të komunikimit nga të gjitha qeveritë e Kosovës për t'i integruar qytetarët e veriut, e kombinuar me natyrën neutrale të UNMIK-ut ndaj statusit, nuk ndihmuan që gjërat të përmirësoheshin në terren. Në vitin 2002 veriu u 'nda' edhe de jure me miratimin e direktivës administrative⁵ nga ish PSSP-ja Michael Steiner, i cili e autorizonte Administratën e UNMIK-ut në Mitrovicë, për ta administruar pjesën e Mitrovicës në veri të lumit Ibër dhe të komunave të tjera të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut, si dhe të merreshin përgjegjësitë e njëjta si të komunave të tjera të Kosovës.

Realpolitika e krijuar në vitin 2008 në veri, pas shpalljes së pavarësisë nga autoritetet kosovare, përbënte në mënyrë të qartë rrezik ndaj stabilitetit jo vetëm të Kosovës, por edhe të rajonit; andaj kjo situatë kërkonte nevojën urgjente për ta përcaktuar statusin e veriut dhe mbase të trajtohej si kompromis mes Kosovës dhe Serbisë. Proceset përcjellëse të dialogut dhe Marrëveshja e Parë e Brukselit që pasoi më pas mund të shihen si kompromisi i parë për zgjidhjen e çështjes së veriut.

STATUSI AKTUAL I ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

Të pesëmbëdhjetë pikat delikate të Marrëveshjes së Parë u pasuan nga plani i zbatimit për të cilin janë pajtuar të dy palët. Ajo që mund të themi me mjaft siguri është se plani ishte tejte ambicioz. Në të parashihej që zbatimi të ndodhte deri në fund të vitit 2013, përveç kësaj plani u bënte thirrje të dy palëve që të "përkushtoheshin në zbatimin e plotë të marrëveshjeve të arritura më parë, d.m.th: kadastrit, regjistrin civil, vulat doganore, diplomat universitare, lirinë e lëvizjes, përfaqësimit rajonal, IBM-it, aranzhimeve të zyrave ndërlidhëse, njësive të veçanta të policisë për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore, dhe mbledhjen e fondeve nga pikat doganore për Kosovën veriore⁶. Plan i zbatimit përfundon papritmas me një rresht të shkurtër që thekson se "Të dy palët do ta vazhdojnë dialogun e tyre politik".⁷

⁴Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kapitulli I. Neni 1.3.

⁵Direktiva administrative e UNMIK nr. 2002/26

⁶Plani i zbatimit. 23 maj 2013.

⁷Ibid.

Ligji i amnistisë

Pika e parë e planit të zbatimit thekson se duhet të bëhet Ligji i amnistisë si 'kërkesë ligjore për zbatim' deri në qershor të vitit 2013.⁸ Ky ligj parashihte që të amnistoheshin kryesisht ata që i kishin shkelur ligjet e Kosovës në veri të vendit. Qeveria e Kosovës e kishte miratuar projektligjin për amnisti kah fundi i qershorit të vitit 2013; presioni për ta kaluar me shpejtësi ligjin për amnisti vinte nga pala serbe, e cila e kushtëzonte miratimin e ligjit në fjalë me shpërbërjen e strukturave të tyre të sigurisë (policisë dhe gjyqësorit). Qeveria e Kosovës nuk e humbi rastin që t'i hulumtojë rrethanat për ta hartuar një ligj më gjithëpërfshirës sesa ai që kërkohej me marrëveshje.⁹ Versioni i parë i ligjit, i cili nuk kaloi në leximin e parë të parlamentit, jepte amnisti për krime serioze në tërë territorin e Kosovës dhe nuk kufizohej vetëm në veri. Kjo e tërhoqi vëmendjen e organizatave të shoqërisë civile dhe më pas edhe të disa prej ambasadave të huaja dhe të ligjvënësve të BE-së, të cilët u përfshinë në vlerësimin e ligjit. Si rezultat i kësaj, parlamentit iu paraqit një version i ri dhe i përmirësuar i ligjit në fillim të korrikut, i cili përkonte me vizitën në Prishtinë të baroneshës Catherine Ashton. Me një fjalë ligji u votua nga shumica në parlament. Pa marrë parasysh kësaj, organizatat e shoqërisë civile dhe të Lëvizjes Vetëvendosje vazhduan t'i shprehnin pakënaqësitë e tyre sa i përket përmbajtjes së ligjit edhe pse versioni i ri i ligjit ishte përmirësuar dhe se do të amnistoheshin 'vetëm ata që ishin përfshirë në akte të rebelimit'. U organizuan protesta dhe peticione në tërë Kosovën, dhe se u mbledhën rreth 13,000 nënshkrime të cilat iu dorëzuan presidentes së Kosovës në mënyrë ceremoniale nga përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët i kërkuan asaj që mos ta nënshkruante ligjin dhe t'ia kthente atë parlamentit për rishikim. Përveç kësaj, ligji u sfidua edhe më tej dhe u dërgua në Gjykatën Kushtetuese nga Lëvizja Vetëvendosje, e cila gjykante se ligji është jo kushtetues dhe i shkelte të drejtat e njeriut. As presidentja e Kosovës e as Gjykata Kushtetuese nuk e përdorën pushtetin e tyre për t'ia ndryshuar formën ligjit.

Procedura e përshpejtuar dhe menaxhimi i dobët i përmbajtjes së ligjit, i shoqëruar me mungesë të funksionit të kontrollit dhe balancimit, në këtë rast

të protestave dhe peticionit të shoqërisë civile, vetëm sa e rritën pakënaqësinë e qytetarëve të rëndomtë, vis-à-vis ndaj institucioneve dhe ndaj procesit jo edhe aq transparent të dialogut.

Zgjedhjet

Pika e dytë e planit të zbatimit u bënë thirrje palëve që ta krijojnë Ekipin Menaxhues për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave serbe në veri deri në fund të muajit maj 2013.¹⁰ Me qëllim që të formohet asociacioni i komunave duhej të mbaheshin zgjedhjet në tërë territorin e Kosovës, veçanërisht në veri të vendit ku ka pasur mungesë totale të përfaqësimit zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës. Zgjedhjet lokale u mbajtën në katër komunat e veriut për herë të parë pas luftës së vitit 1999, më 3 nëntor të vitit 2013.

Megjithatë, për t'u mbajtur zgjedhjet do të duhej të vihej në lëvizje edhe një proces tjetër i përshpejtuar. Banorëve serbë të veriut, të cilët deri atëherë lavdëroheshin si 'patriotë' dhe 'mbrojtës' të 'Kosovës serbe'¹¹, iu kërkuu nga Beogradi të merrnin pjesë në zgjedhje dhe t'i braktisnin institucionet paralele serbe pjesë e të cilave kishin qenë për katërmbrëdhjetë vjet. Natyrisht që mungesa e transparencës së dialogut dhe të çfarëdo forme të demokracisë i zuri qytetarët e zakonshëm pa u përgatitur dhe nuk kishin ide lidhur me pasojat e marrëveshjes në jetën e tyre të përditshme e as për të ardhurat e tyre, shumica e të cilëve ishin paguar deri atëherë nga institucionet serbe. Shpesh na përsëritet tema: fati i serbëve të Kosovës është që të mos vendosin për fatin e vet.¹²

Zgjedhjet lokale të nëntorit të vitit 2013 dhe balotazhi i dhjetorit e ndryshoi skenën politikë në tërë Kosovën, sidomos kishin ndikim të madh në skenën politike të serbëve të Kosovës. Disa muaj para zgjedhjeve u krijua Iniciativa Qytetare (Gradanska Inicijativa Srpska – GIS, e njohur edhe si *Srpska*) e cila do të mbledhë nën ombrellën e partive politike të sponsorizuara nga Beogradi, dhe më pas ajo fitoi në 9 prej 10 komunave me shumicë serbe, duke përfshirë edhe komunat në jug të

⁸Ibid.

⁹Kurt Bassuener dhe Bodo Weber; *Ende e papërfunduar: Kosova dhe Marrëveshja Prishtinë-Beograd. Dokument i politikave nga DPC. Nëntor 2013. Sarajevë-Berlin.*

¹⁰Plani i zbatimit. 23 maj 2013.

¹¹Andreas Ernst, 'Zgjedhjet lokale në Kosovë – një hap më afër normalizimit?' Reflektim kritik. 19 dhjetor 2013.

¹²Petar Miletic, nënkryetar i Kuvendit të Kosovës i cituar në Andreas Ernst, 'Zgjedhjet lokale në Kosovë – një hap më afër normalizimit?' Reflektim kritik. 19 dhjetor 2013.

Kosovës, shumica e të cilave deri atëherë qeveriseshin prej SLS-së (Samostalna Liberalna Stranka – Partia e Pavarur Liberale), e njohur ndryshe edhe si 'Serbët e Thaqit'. Vetëm në komunën e Shtërpçës në jug të Kosovës SLS-ja ia doli ta mbante pushtetin.

Rezultatet e zgjedhjeve e bënë listën *Srpska* të sponsorizuar nga Beogradi palën më të fuqishme në politikën kosovare. Po e paraqesin një pasqyrë të përgjithshme, PDK-ja – partia më e madhe në Kosovë – i kontrollon dhjetë komuna, ndërsa LDK-ja – partia kryesore dhe më e madhe opozitare, qeverisë në nëntë komuna. Kjo mund të nënkuptojë se jo vetëm politika e Beogradit do t'i mbante frerët në komunat veriore, por tanimë kishte ndikim të madh edhe në komunat e tjera serbe në tërë Kosovën. Duket qartë se 'serbët e Thaqit' janë marginalizuar dhe se investimi në SLS me vite të tëra prodhoi rezultate të dobëta në një kohë mjaft të rëndësishme. Situata e re politike jo vetëm që e vuri në pikëpyetje integritimin e serbëve në Kosovë gjatë katërmëdhjetë vjetëve të shkuara, por edhe të ardhmen e tyre, duke e pasur parasysh garën kundër nismave të Beogradit dhe të manipulimeve politike për t'i përforcuar lidhjet me mëmëdheun dhe sjelljen edhe më shumë të 'Serbisë në Kosovë'.

Së këndejmi, diskursi politik i zhvilluar prej aktorëve të ndryshëm në Serbi nuk vjen si habi kur thonë sesi Marrëveshja e Parë e Brukselit ka siguruar për herë të parë institucione etnike serbe në Kosovë, të cilat njihen si nga BE-ja edhe nga autoritetet e Prishtinës dhe se 'etnia e re' (Zajednica Srpskih Opstina – ZSO) do të hap kanale të reja zyrtare për Beogradin që të ndikojë dhe ta mbrojë popullatën serbe në Kosovë.

Po ashtu, procedurat e përshpejtuara dhe jo korrekte të zgjedhjeve me anë të së cilave u mbajtën ato në veri – prej regjistrimit të partive dhe të votuesve, prej komunikimit me publikun, fletëvotimeve, mungesës së pranisë së institucioneve të Kosovës, e deri tek menaxhimi i OSBE-së e cila i organizoi dhe e mbikëqyri procesin – e bëjnë të diskutueshme çështjen nëse ato zgjedhje të mbajtura për herë të parë ishin të lira dhe të drejta. Si pasojë, institucionet që dolën si rezultat i këtyre zgjedhjeve nuk e kanë një bazë të fortë për ta fituar besimin, mbështetjen dhe legjitimitetin në sy të popullsisë lokale.

Asociacioni i Komunave

Edhe pse zgjedhjet lokale u mbajtën në veri në kuadër të një situatë komplekse katër rundesh, pastaj të vrasjes së një kandidati dhe të arrestimit të një tjetri, me një dalje të përgjithshme prej 20 për qind, kandidatët megjithatë u zgjodhën dhe se procesi u mirëprit si një proces i suksesshëm nga partitë politike.

Por krijimi dhe konstituimi i autoriteteve të reja nëpër komuna është duke u zhvilluar me një hap tejte të ngadalshëm. Problemet vazhdojnë të jenë të pranishme, si ajo e statuseve të komunave si dhe e zhvillimit të kapaciteteve administrative.

Kryetarët e ri të zgjedhur të komunave kanë mbetur mes politikës së Beogradit dhe të respektimit (apo mungesës së respektit) të legjislacionit të Kosovës – çështjet si flamurët, vulat dhe pjesëmarrja vazhdojnë ta pengojnë miratimin e statuseve të komunave. Integrimi i një numri të madh të punonjësve nga strukturat paralele në strukturat e reja komunale është po ashtu një problem i konsiderueshëm për faktin se komunat e reja thjeshtë nuk kanë kapacitete që t'i absorbojnë të gjithë ata.

Formimi jo aq i lehtë i komunave shërben si pengesë për zbatimin e pikës së parë të marrëveshjes së parë, e cila e përcakton formimin e 'Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë' (ZSO).¹³ Zbatimi i pikës së parë ishte paraparë që të realizohej pas përfundimit të zgjedhjeve lokale, më së shumti deri në fund të vitit 2013.

Deri më sot, grupi menaxhues për përgatitjen e formimit të asociacionit është krijuar sipas një vendimi të marrë nga Ministria e Pushtetit Lokal në Kosovë, dhe përbëhet prej përfaqësuesve të secilës prej katër komunave veriore. Përveç kësaj, edhe statuti për formimin e Asociacionit është hartuar nga MAPL, porse themelimi i vet asociacionit ka mbetur ende pezull.

Sipas marrëveshjes së parë dhe të planit të zbatimit, asociacioni do të ketë për detyrë që të merret me çështje si shëndetësia, arsimi, zhvillimi ekonomik, planifikimi urban dhe rural, si dhe 'kompetenca të tjera shtesë të cilat do t'i delegoheshin prej

¹³Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. 19 prill 2013.

autoriteteve qendrore'.¹⁴ Po ashtu, Asociacioni do ta ketë një ulëse në këshillin konsultativ të bashkësive me rol monitorues.

Gjersa skeptikët do t'ju pëlqente ta krahasonin Asociacionin si një entitet me Republikën Srpska në Bosnje, diskursi politik që vjen prej institucioneve të Prishtinës flet për një 'OJQ', ndërsa në sytë e Beogradit Asociacioni është një 'lloj entiteti' përmes së cilit serbët do të jenë në pozitë ta qeverisin vetveten në mënyrë autonome prej Prishtinës. Është e qartë se Asociacioni nuk do të ketë fuqi të vetos për t'i bllokuar vendimet në nivelin qendror, por në aspektin politik do të ketë fuqi që t'i paraqes dhe të shtyjë përpara interesat politike të një grupi të caktuar. Në këtë mënyrë, ai mund ta vë në rrezik funksionalitetin e shtetit, dhe si i tillë mund ta zgjerojë hendekun e segregacionit mes serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës – me fjalë të tjera do të vihet në pikëpyetje i tërë koncepti shumetnik i Kosovës.

Strukturat e sigurisë

Pikat shtatë dhe nëntë të marrëveshjes së parë kanë të bëjnë me sektorin e policisë. Ato bëjnë thirrje për integrimin e të gjithë pjesëtarëve të policisë në veri të Kosovës në strukturat e Policisë së Kosovës. Po ashtu theksohet se 'do të ketë një forcë policore në Kosovë'.¹⁵ Në gusht të vitit 2011, kancelarja Merkel i tha publikisht presidentit të atëhershëm të Serbisë që ta largonte aparatën e sigurisë nga veriu i Kosovës dhe t'i shpërbënte strukturat paralele të komunave si parakusht për vazhdimin e rrugës së Serbisë për në BE. Heqja e strukturave paralele, e sidomos të strukturave të sigurisë, ishte e nevojshme, dhe se kjo gjë kërkohej me ngulm nga zyrtarët e tjerë ndërkombëtarë që e vizitonin Beogradin, me qëllim që të sigurohej stabiliteti në Kosovë, si dhe stabiliteti i serbëve në veri, duke e pasur parasysh se pjesa veriore e vendit ishte bërë strehë e kontrabandës dhe e aktiviteteve të tjera kriminale si pasojë e mungesës së ligjshmërisë për katërmëdhjetë vjet më radhë.

Plani i zbatimit thekson se deri në fund të muajit maj të vitit 2013 do të krijohet një grup i përbashkët punues me qëllim të zbatimit të pikave shtatë, tetë dhe nëntë të marrëveshjes së parë. Deri në qershor/korrik Serbia do të duhej të 'fillonte procesin e mbylljes së strukturave të sigurisë si dhe të objekteve të tyre', dhe se deri në fund të vitit 'pjesëtarët e strukturave të sigurisë në Kosovë do të

integroheshin plotësisht në strukturat ekuivalente të Kosovës dhe se do t'i merrnin pagat ekskluzivisht prej buxhetit të Kosovës'.¹⁶

Integrimi i 285 pjesëtarëve të MUP¹⁷ tashmë ka filluar edhe pse disa muaj me vonesë sesa që parashihet në planin e zbatimit.

Megjithatë, procesi nuk duket të jetë aq i thjeshtë dhe se po përcillet me plotë mospajtime organizative: pronësia e procesit të verifikimit, koha e shkurtër e trajnimeve fillestare, marrëveshja për policinë që të jetë e aplikueshme vetëm në veri, dhe rritja e raporteve të mediave sa i përket çështjes së lojalitetit të oficerëve të MUP ndaj zinxhirit komandues të PK-së.¹⁸

Përveç kësaj, procesi përcillet prej pasigurive sa i përket themelimit të komandës rajonale të PK në veri. Marrëveshja e parë, në pikën e saj numër nëntë, thekson se 'do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe. Komandanti i këtij rajoni do të jetë serb i Kosovës i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit.' Meqë themelimi i asociacionit ka mbetur pezull, edhe funksionimi i komandës rajonale në veri është në pritje gjithashtu. Për momentin, megjithatë, është caktuar një zëvendësues.

Gjyqësia

Pika dhjetë e Marrëveshjes së Parë thekson: 'Autoritetet gjyqësore do të integrohen dhe do të veprojnë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Gjykata e Apelit në Prishtinë do të themelojë një panel i përbërë nga një shumicë e gjykatësve serbë të Kosovës për t'u marrë me të gjitha komunat e Kosovës me shumicë serbe. Një divizion i kësaj Gjykate të Apelit, i përbërë nga staf administrativ dhe gjyqtarë, do të vendoset në mënyrë të përhershme në Mitrovicën veriore (në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës). Secili panel i divizionit të mësipërm do të përbëhet nga një shumicë e

¹⁶Plani i zbatimit. 23 maj 2013.

¹⁷Ministarstvo Unutrasnjih Poslova (Reublike Serbije) – Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë

¹⁸Maja Bjelos, Bojan Elek dhe Fjolla Raifi, 'Integrimi i Policisë në veri të Kosovës: progresi dhe sfidat që mbeten në zbatimin e marrëveshjes së Brukselit.' Botim i QBPS dhe i QKSS. Beograd dhe Prishtinë, mars 2014.

¹⁴Ibid.

¹⁵Ibid.

gjyqtarëve serbë të Kosovës. Gjyqtarët përkatës do të vendosen varësisht nga natyra e rastit në fjalë.¹⁹

Po kështu, dhe në pajtim me planin e zbatimit²⁰, palët do ta formojnë një grup punues, i cili ka për detyrë hartimin e planeve të detajuara për integrimin e autoriteteve gjyqësore serbe në strukturat e Kosovës dhe në formimin e çfarëdo strukture të re që kërkohet sipas marrëveshjes, duke përfshirë edhe gjykatat themelore edhe zyrën e prokurorit publik në komunat me shumicë serbe. Në ndërkohë, Serbia duhet të ofrojë informata lidhur me numrin e personelit të saj gjyqësor të punësuar në Kosovë, dhe të cilët kanë shprehur interes që të inkuadrohen në strukturat e Kosovës menjëherë pas miratimit të ligjit të amnistisë.²¹ Integrimi i autoriteteve gjyqësore ishte paraparë që të përfundonte deri në fund të vitit 2013. Derisa po e shkruanim këtë analizë të shkurtër (prill 2014) ende nuk është arritur ndonjë marrëveshje, dhe se nuk është e qartë se kur do të arrihet një e tillë. Ajo pak që dihet për publikun përmes raportimit të medias na e lë përshtypjen se do të kalojë një kohë e konsiderueshme deri atëherë kur të gjenden pika të përbashkëta për të dy palët në lidhje me pikën dhjetë të marrëveshjes.

CILA ËSHTË E ARDHMJA E MARRËVESHJES SË PARË

Procesi i dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, i udhëhequr gjatë viteve të fundit nga BE-ja, natyrisht se nuk mund të lavdërohet për transparencë, demokraci e gjithëpërfshirje. Ai është mbajtur me kujdes në dijeni vetëm të vendimmarrësve kryesorë. Në përgjithësi, ekziston vetëm një grusht njerëzish të përfshirë në proces dhe sigurisht se pronësia e procesit nuk i takon qytetarëve të Kosovës e as të Serbisë. Gjatë tërë procesit janë përjashtuar pothuajse tërësisht elementet e tjera të shoqërisë, si shoqëria civile, institucionet akademike, shoqata e personave të pagjetur, e kështu më radhë. Edhe më keq, ekipet politike të Kosovës dhe Serbisë gjatë tërë kohëzgjatjes së dialogut ishin më tepër përgjegjës ndaj BE-së sesa popujve të tyre të cilët i kishin zgjedhur.

Politikën që e bënte BE-ja në marrëdhëniet Serbi-Kosovë, dhe të mbështjellë me terminologji të ndërtimit të shtetit, nuk duket se do t'i jepte frutat e

nevojshëm e le më frutat e dëshiruara. Deri më tani, zbatim i Marrëveshjes së Parë ka dëshmuar të jetë shumë kompleks dhe aspak i lehtë; kjo kryesisht për shkak të qasjes së gabuar të BE-së dhe të përpjekjeve të saj që ta lidhë një proces të vërtetë për paqe me procesin e integritetit në BE. Duket se parapëlqehet që të dy këto procese të shkojnë së bashku, porse ato kanë një dinamikë dhe kohëzgjatje të ndryshme. Për fat të keq, procesi i vërtetë i paqes në Kosovë ende nuk ka filluar, dhe se fokusi është vënë vetëm në përforsimin e institucioneve; ndërsa ndarja e bashkësive do të qon në zhgënjim dhe mungesë të rezultateve të duhura.

Duke e parë rëndësinë e anëtarësimit në BE, natyrisht se të dy vendet do të dëshironin që t'i plotësonin kriteret që t'i bashkoheshin këtij klubi. Mirëpo këto dy procese kanë dinamika të ndryshme, dhe njëra nuk mund ta zëvendësojë tjetrën; edhe pse BE-ja e përdor qasjen e 'karotës dhe të shkopit', kjo nuk i ka sjell rezultatet e nevojshme në terren dhe në procesin e pajtimit, e cili është gjëja më e rëndësishme për shqiptarët dhe serbët në Ballkan. Një shënim për lexuesin: ende janë 1754 persona të pagjetur që përbën një pengesë të madhe për fillimin e procesit të pajtimit.

Nxitimi dhe nevoja e ngutshme për ta arritur marrëveshjen e prillit të vitit 2013 nuk ishte fare pa agjendë. Më 28 qershor 2013, Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian²² do të takoheshin për të marrë vendim nëse do t'i hapnin negociatat për anëtarësim të Serbisë në janar të vitit 2014 dhe për hapjen e negociatave për marrëveshjen e stabilizim-asocimit me Kosovën, e gjithë kjo varej prej zbatimit të suksesshëm të saj. Tani jemi në prill të vitit 2014 dhe se nuk është arritur pothuaj as 30 për qind e zbatimit të marrëveshjes. Në janar të vitit 2014 Serbia i filloi negociatat për anëtarësim; ndërsa Kosovës iu premtua nënshkrimi i MSA-së në pranverën e vitit 2014, por vetëm iu premtua. Natyrisht se zyrës së baroneshës Ashton i duhej një tregim i suksesshëm për ta përfunduar mandatin, Kosova dhe Serbia besojnë se marrëveshja e parë do t'i afrojë vendet e tyre më afër BE-së dhe se do t'i mbante politikanët e njëjtë në pushtet, gjersa qytetarët e rëndomtë janë të habitur e të hutuar lidhur me të ardhmen e tyre dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre. Pa një pajtim të vërtetë dhe të përhershëm dhe të një procesi të paqes mes serbëve

¹⁹Marrëveshja e parë e parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve. 19 prill 2013.

²⁰Plani i zbatimit. 23 maj 2013.

²¹Ibid.

²²Këshilli i Evropës 27/28 qershor 2013 përfundimet, për më shumë shih: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/ec/137634.pdf

dhe shqiptarëve në Ballkan marrëveshja e parë është larg së qenit marrëveshje historike. Me shpresë që koha ta dëshmojë që kjo analizë e shkurtër politike të jetë i gabuar!

Për autoren:

Engjellushe Morina është bashkëthemeluese dhe kryesuese e Këshillit të Prishtinës për Marrëdhënie me Jashtë, një institut i pavarur me seli në Prishtinë. Engjellushe Morina më parë ka qenë drejtoreshë ekzekutive e Iniciativës Kosovare për Stabilitet – IKS (2008-2012), një institut me seli në Prishtinë që përqendrohej në problemet socio-ekonomike dhe socio-politike. Pas një përvoje të gjatë arkeologjike në Egjipt, Shqipëri, Itali dhe Mbretëri të Bashkuar, ajo u kthye në Kosovë në vitin 1999 për ta ndihmuar zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe politik të vendit. Këtu përfshihet edhe ndihma vullnetare e dhënë në themelimin e partisë së tretë më të madhe politike të kohës. Para se të fillonte punën me IKS-në, Engjellushja e ka menaxhuar arsimin e lartë në Sektorin për Marrëdhënie me Publikun në Ambasadën e SHBA-ve në Prishtinë (2001-2006). Gjatë negociatave lidhur me statusit politik të Kosovës, ajo ka shërbyer si eksperte dhe konsulente në grupin e trashëgimisë kulturore në kuadër të Ekipit të Unitetit (2005-2007). Kontributi i saj u përqendruar veçmas në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në Kosovë. Që prej vitit 2007, ajo ka qenë bashkautor i një varg raportesh të IKS-së dhe të analizave të ekonomisë politike të Kosovës dhe të çështjeve aktuale të vendit, si dhe vazhdon të kontribuojë rregullisht nëpër editoriale në gazetatat lokale. Engjellushja e ka studiuar arkeologjinë greke dhe romake në Institutin e Arkeologjisë në Kolegjin Universitar të Londrës (University College London – UCL), dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Diplomatie në Universitetin e Oksfordit (Somerville College).

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë pikëpamje personale të autorit dhe nuk paraqesin doemos pikëpamjet e fondacionit Konrad-Adenauer-Stiftung.

Kontakti:

Konrad-Adenauer-Stiftung

Zyra në Kosovë
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6
KO-10000 Prishtinë
Telefoni +381 (0) 38 229 874
Prishtina@kas.de
ëëë.kas.de/kosovo